Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0291

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi - kryetare duke vendosur sipas ankesës së OE " Enggroup " SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE" me numër të prokurimit 214-23-1131-2-2-1, inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 20/06/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e " Enggroup " SH.P.K. me nr. 2023/0291, e datës 22/05/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE", me numër të prokurimit 214-23-1131-2-2-1, inicuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, nderkaq mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale* -

Me datën 03.03.2023, AK – POLICIA E KOSOVËS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull "SHËRBIME

PROFESIONALE INXHINJERIKE" me numër të prokurimit 214-23-1131-2-2-1.

Ndërsa me datën 02.05.2023 AK – POLICIA E KOSOVËS ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se çmimet e peshuara të ofruara nga të dy Operatoret ekonomik kanë çmime abnormalisht të ulta se çmimet e planifikuara të peshuara nga AK.

Me datën 05.05.2023 Operatori ekonomik ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim. AK-POLICIA E KOSOVËS me datë 12.05.2023 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik dhe ka lënë në fuqi njoftimin e AK lidhur me anulimin e aktivitetit.

I pakënaqur me vendimin e AK, me datën 22.05.2023 Operatori ekonomik " Enggroup " SH.P.K me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0291, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbime, dhe vlera e parashikuar e kontratës: 90,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu edhe nenit 108/A të ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie në kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

-*Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 02.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër përmban elementet qenësore dhe i njëjti i është dërguar autoritetit kontraktues dhe ankuesit. Lidhur me këtë raport të ekspertizes AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik ankues nuk ka dhënë mendim rreth raportit të ekspertit.

Përgjigje në Pretendimet Ankimore të OE ankues

Eksperti shqyrtues, sqaron se pala e pakënaqur me vendimin e AK-Policisë se Kosovës për anulim të aktivitetit te prokurimit, ka parashtruar ankesë në OSHP, me datën: 19.05.2023, duke pretenduar me rastin e vlerësimit të ofertave Autoriteti kontraktues, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues është eliminuar me arsyetimin se:

Sa i përket arsyes se eliminimit të OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se Rregullorja për çmime Jo/Normalisht ulëta nuk mund të aplikohet për faktin se nga katër operatorë ekonomik të interesuar për ketë aktivitet të prokurimit vetëm dy janë të përgjegjshëm, përderisa kushti i parë për aplikim të rregullores për çmime jo normalisht të ulëta është të jenë tri oferta të përgjegjshme.

Autoriteti kontraktues, me datë: 24.04.2023, në harmoni me nenin 61 të LPP-së i është drejtuar OE-ve, konkretisht OE ankues me kërkesë për sqarim të çmimit/pozicioneve.

OE ankues në përgjigje të kërkesës së AK-së, i ka dhënë faktet dhe argumentet e veta dhe njëherit edhe në ankesën e tij të parashtruar në OSHP, deklaron se i qëndron çmimit të dhënë në ofertën e tij financiare dhe se i njëjti deklaron që është i gatshme ta pranoj rritjen e sigurisë së ekzekutimit.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në dispozitat e nenit 61 të LPP-së, konkretisht paragrafit 4 të këtij neni, vlerëson se është e drejtë e autoritetit kontraktues vlerësimi i çmimeve, sepse në paragrafin 4 thuhet se:

61.4 Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzoj tenderin.

Bazuar në sqarimet e dhëna më lartë në veçanti bazuar në paragrafin 4 të nenit 61 të LPP-së, eksperti shqyrtues vlerëson se, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e Autoritetit Kontraktues, prandaj pretendimi OE ankues, për shkelje të dispozitave të LPP-së nuk qëndron.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura dhe pretendimet ankimore të lartcekura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

- Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuar
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Seanca dëgjimore -

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca degjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre, ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues pasi shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, diskutimit dhe analizimit të provave në tërësi vlerëson se ankesa e Operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe mbetet në fuqi vendimi i AK. Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit "SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE", me numër të prokurimit 214-23-1131-2-2-1, pasi fillimisht ka vepruar konform nenit 61 paragrafi 1 duke kërkuar sqarim të çmimit/pozicioneve dhe pas pranimit të informacioneve dhe sqarimeve, konform nenit 61 paragrafi 4, duke konstatuar se sqarimet e derguara nga ana e OE ankues nuk kanë qenë të argumentuara ne prova dhe fakte materiale dhe mbi ketë bazë edhe eshte anuluar aktiviteti i prokurimit.

Në vijim, Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 103 të LPP-së sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet

juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë.

Duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **" Enggroup " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: